



# **ORGANIZIMI I PROVIMEVE PRANUESE NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS MODELE TË PYETJEVE/DETYRAVE**

# PRANIMI NË STUDIMET BAÇELOR

Pranimi i studentëve në Universitetin e Prishtinës realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, parimet e transparencës, meritës dhe mundësive të barabarta për të gjithë kandidatët.

Çdo kandidat që ka përfunduar me sukses arsimin e mesëm dhe ka kaluar testin e maturës shtetërore gëzon të drejtën të aplikojë për regjistrim në studimet baçelor. Kandidatët duhet të dëshmojnë përfundimin e së paku 12 viteve të arsimit formal përmes diplomës përkatëse. Kandidatët që kanë përfunduar arsimin jashtë Kosovës mund të aplikojnë vetëm pasi diploma e tyre të jetë njohur dhe barasvlerësuar nga institucioni kompetent shtetëror.

Për secilin cikël të pranimit, Senati i Universitetit, bazuar në propozimet e njësive akademike, miraton kriteret e detajuara të përzgjedhjes së kandidatëve. Këto kriteret mund të përfshijnë:

- suksesin e arritur në arsimin paraprak,
- rezultatet e testit të maturës,
- provimet pranuese, si dhe elemente të tjera të nevojshme për programet specifike të studimit.

Po ashtu, Senati përcakton procedurat për organizimin e provimeve pranuese, trajtimin e ankesave dhe zbatimin e provimeve diferenciale për kategori të caktuara të studentëve.

Secila njësi akademike në varësi të specifikave të saj përcakton kriteret e pranimit të cilat paraqiten në konkurs.

Më poshtë janë paraqitur disa të dhëna për organizimin e provimit pranues dhe modele të pyetjeve/detyrave për provim pranues në secilën Njësi Akademike.

# PËRZGJEDHJA E KANDIDATËVE

Për të gjitha fakultetet, (përveç Fakultetit të Arkitekturës), do të bëhet sipas kritereve të përcaktuara më poshtë.

▶ Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës: Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë dhe atë:

- Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë dhe
- Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.

▶ Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës: Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë dhe atë:

- Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
- Suksesi në maturë deri në 30 pikë dhe
- Suksesi në provimin pranues deri në 40 pikë.

- Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi, kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues, deri në numrin e paraparë sipas konkursit.
- Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
- Për kandidatët që konkurrojnë në kuadër të kuotave të rezervuara të përcaktuara (komunitetet joshumicë, kandidatët nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, Maqedonia e Veriut, Republika e Shqipërisë, Mali i Zi, komuniteti arbëresh i Italisë dhe arbneshët e Zarës, shqiptarët e Turqisë, si dhe mërgata shqiptare me prejardhje nga Kosova), kusht për t'u kualifikuar për regjistrim është arritja e së paku 30% të pikëve në provimin pranues. Kandidatët që nuk arrijnë këtë prag minimal nuk mund të përfitojnë nga kuotat e rezervuara, pavarësisht numrit të vendeve të lira të përcaktuara për secilën kategori.
- Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues në lëndët mësimore, të cilat i caktojnë vetë fakultetet.
- Fakultetet me specifika të veçanta organizojnë provim praktik në lëndë dhe disiplina përkatëse.
- Detajet e tjera përcaktohen në konkurs.
- Për Fakultetin e Arkitekturës, përzgjedhja është pasqyruar te Fakulteti i Arkitekturës.

# DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM FIZIK

- a) Ekstrakti i lindjes (original) jo më i vjetër se 6 muaj;
- b) Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (originale, dublikatë ose të noterizuara);
- c) Diploma e kryerjes së shkollës së mesme (originale, dublikatë ose e noterizuar);
- d) Dëftesa e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (originale, dublikatë ose e noterizuar);
- e) Kopjen e letërnjoftimit;
- f) Të ngarkohet një fotografi profesionale, të realizuar në fotostudio, sipas standardeve për dokumente zyrtare (si fotografia për pasaportë ose vizë). Fotografia duhet të jetë me dimensione 35 × 45 mm, me fytyrën ballë përballë, sfond të bardhë ose të pastër dhe të ruhet në formatin JPG, JPEG ose PNG.
- g) Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: Vegza (linku) për konkurrim online përmes internetit është: <http://apliko.uni-pr.edu>;
- h) Dëshmia mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit. (nëse kandidatët nuk mund ta sigurojnë këtë dëshmi gjatë periudhës së aplikimit online, atëherë dëshmia mund të dorëzohet me rastin e aplikimit fizik).

# FAKULTETI FILOZOFIK

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të degëve mësimore të fakultetit dhe atë:

- Në Departamentin e Filozofisë, nga Filozofia dhe Sociologjia;
- Në Departamentin e Punës Sociale, nga Edukata qytetare, Psikologjia dhe Sociologjia dhe verifikimi i aftësive të përgjithshme për studime;
- Në Departamentin e Historisë, nga Historia e botës, Historia e popullit shqiptar dhe Edukata qytetare;
- Në Departamentin e Shkencave Politike, nga Sociologjia, Filozofia, Historia dhe Edukata qytetare;
- Në Departamentin e Sociologjisë, nga Sociologjia dhe Filozofia;
- Në Departamentin e Psikologjisë, nga Psikologjia, Filozofia dhe Verifikimi i aftësive të përgjithshme për studime;
- Në Departamentin e Antropologjisë, nga Historia, Letërsia dhe Sociologjia

## MODELE TË PYETJEVE

### Departamenti i Historisë

Programi: Histori (Bachelor)

**Pavarësia e Shqipërisë u shpall në vitin:**

- a. 1878
- b. 1830
- c. 1899
- d. 1912

### Departamenti i Filozofisë

Programi: Filozofi (Bachelor)

**Përfaqësuesit kryesorë të filozofisë racionaliste janë:**

- a. Spinoza, Dekarti, Lajbnici
- b. Xhejmsi, Peirce, Djuj
- c. Lloku, Hjumi, Hobsi
- d. Kanti, Fihte, Hegeli

### Departamenti i Sociologjisë

Programi: Sociologji (Bachelor)

**Çfarë nënkupton koncepti i imagjinatës sociologjike i zhvilluar nga C. Wright Mills?**

- a. Përdorimin e statistikave për të analizuar sjelljen individuale
- b. Aftësinë për të parë lidhjen midis përvojave personale dhe strukturave shoqërore më të gjera
- c. Zëvendësimin e ndjenjave personale me fakte shkencore
- d. Fokusimin vetëm në veprimet individuale pa marrë parasysh kontekstin social

### **Departamenti i Psikologjisë**

Programi Psikologji (Bachelor)

**Në një klasë, shumica e nxënësve vendosin të mos përgjigjen në pyetjet e mësuesit gjatë orës. Edhe pse Blendi i di përgjigjet, ai vendos të qëndrojë i heshtur për të mos u dalluar nga të tjerët. Kjo sjellje është shembull i cilit koncept?**

- a. Konformizëm
- b. Pajtim
- c. Individualizëm
- d. Bindje

### **Departamenti i Shkencave Politike**

Programi: Shkenca Politike (Bachelor)

**Rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet shteteve që filloi të bazohej në parimin e sovranitetit territorial, konsiderohet se origjinën e ka që nga:**

- a. Konferenca e San Franciskos 1945
- b. Paqja e Westfalisë 1648
- c. Kongresi i Berlinit 1878
- d. Kongresi i Vjenës 1815

### **Departamenti i Punës Sociale**

Programi: Punë Sociale (Bachelor)

**Cila qasje psikologjike thekson rëndësinë e proceseve mendore si perceptimi, kujtesa dhe zgjidhja e problemeve në kuptimin e sjelljes njerëzore?**

- a) Perspektiva Kognitive
- b) Perspektiva Behavioriste
- c) Perspektiva Psikodinamike
- d) Perspektiva Humaniste

**Cili numër zëvendëson në serinë: 1, 1, 2, 3, 5, 8, ?**

- a. 13
- b. 10
- c. 11
- d. 12

### **Departamenti i Antropologjisë**

Programi: Antropologji dhe trashëgimi kulturore (Bachelor)

**Kryeqyteti i Mbretërisë Dardane ishte:**

- a. Shkupi
- b. Ulpiana
- c. Vendenisi
- d. Dresniku

# FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të departamentit përkatës të fakultetit dhe atë:

- Në Departamentin e Matematikës, nga Matematika;
- Në Departamentin e Fizikës, nga Fizika dhe Matematika;
- Në Departamentin e Kimisë, nga Kimia, Fizika dhe Matematika;
- Në Departamentin e Biologjisë, nga Biologjia dhe Kimia;
- Në Departamentin e Gjeografisë, nga Gjeografia.

Në testet e provimit pranues, të cilat kanë detyra, krahas qarkimit të përgjigjes së saktë, duhet të ofrohet edhe zgjidhja e detyrës.

## MODELE TË PYETJEVE

### Pyetje nga matematika

09.09.2024

1. Të njehsohet vlera e shprehjes

$$\frac{2}{9} - \frac{1}{3} \left( \frac{2}{3} - \frac{3}{2} \right).$$

- A.  $\frac{1}{3}$
- B.  $\frac{1}{4}$
- C.  $\frac{1}{2}$
- D.  $\frac{3}{2}$

2. Bashkësia e zgjidhjeve e pabarazimit

$$-4x + \frac{2}{3} > 2$$

është:

- A.  $x < -\frac{1}{3}$ ,
- B.  $x < \frac{1}{3}$ ,
- C.  $x > -\frac{1}{3}$ ,
- D.  $x > \frac{1}{3}$ .

3. Për sa rritet vëllimi i kubit nëse brinja e tij rritet për 10%

- A. 33%
- B. 33.1%
- C. 30%
- D. 10%

# FAKULTETI I FILOLOGJISË

Provimi pranues mbahet nga lëndët e fushës së ngushtë profesionale të departamentit përkatës të fakultetit:

- Në Programin e Gjuhës Shqipe, nga Gjuha shqipe (me shkrim);
- Në Programin e Letërsisë Shqipe, nga Letërsia shqipe (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, nga Gjuha angleze (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, nga Gjuha gjermane (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Frënge, nga Gjuha frënge (me shkrim);
- Në Programin e Gazetarisë provimi pranues mbahet në formë testi nga këto lëmi: Gjuhë shqipe, Letërsi shqipe, Qytetërim shqiptar, Qytetërim botëror dhe Ese.
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Turke, nga Gjuha turke (me shkrim);
- Në Programin e Orientalistikës provimi pranues mbahet në formë testi nga këto lëmi: Gjuhë turke dhe arabe (njohuri elementare), Qytetërim islam, Kulturë orientale (me shkrim); - Provimi pranues në Programin Ballkanistikë mbahet me shkrim nga gjuha amtare e kandidatit/ës dhe nga gjuha ballkanike, për t'u përcaktuar saktë niveli gjuhësor i kandidatit/ës.

Për kandidatët shqiptarë, gjuhë ballkanike është njëra nga gjuhët: BSKM (boshnjake, serbe, kroate, malazeze), ndërkaq për kandidatët joshqiptarë, gjuhë ballkanike në këtë program është gjuha shqipe.

## MODELE TË PYETJEVE

### **Programin e Gjuhës Shqipe, nga Gjuha shqipe (me shkrim);**

Pyetjet janë të strukturuar sipas niveleve të ndryshme të të nxenit, ato synojnë të vlerësojnë si njohuritë teorike, ashtu edhe aftësitë për tu zbatuar në kontekste konkrete.

Kërkesat hartohen në përputhje me natyrën e disiplinave përkatëse gjuhësore që përfshihen në test, si: fonetika, morfologjia, sintaksa, drejtshkrimi, historia e standardizimit të gjuhës shqipe, si dhe njohuri bazike nga letërsia dhe kultura shqiptare.

### **Letërsisë Shqipe, nga Letërsia shqipe (me shkrim);**

Testi hartohet për të vlerësuar njohuritë dhe kompetencat letrare e gjuhësore që nxënësit kanë fituar gjatë arsimit parauniversitar. Pyetjet përzgjidhen në mënyrë të balancuar dhe mbulojnë fusha të ndryshme të programit mësimor, duke përfshirë letërsinë shqipe, letërsinë botërore dhe njohuritë bazë gjuhësore.

Kategoritë e pyetjeve mund të përfshijnë:

- 1) Njohjen e autorëve dhe veprave, si: Identifikimi i autorëve sipas veprave. Identifikimi i veprave sipas autorëve. Njohja e jetës dhe veprimtarisë së autorëve kryesorë.
- 2) Njohjen e periudhave letrare
- 3) Njohjen e rrymave dhe drejtimeve letrare
- 4) Njohjen e gjinive dhe llojeve letrare
- 5) Analizën e veprës letrare: Tema dhe ideja. Personazhet. Konflikti. Koha dhe hapësira artistike. Mesazhi i veprës.
- 6) Interpretimin e fragmenteve letrare
- 7) Njohjen e figurave stilistike
- 8) Njohjen e teorisë së letërsisë
- 9) Letërsinë botërore: Autorët dhe veprat më përfaqësuese. Periudhat dhe rrymat letrare. Krahasime mes autorëve dhe veprave.
- 10) Aftësitë kritike dhe argumentuese: Interpretimi personal i tekstit. Argumentimi i mendimeve me shembuj nga vepra. Nxjerrja e përfundimeve kritike.
- 11) Njohuritë gjuhësore

# MODELE TË PYETJEVE

**Shembuj të pyetjeve nga testi pranues i Programit BA Letërsi shqipe**

**1. Cili është libri më i vjetër shqip që njihet deri më sot?**

- a. "Meshari" i Gjon Buzukut
- b. "Formula e Pagëzimit"
- c. "Fjalorthi i Anorl'd fon Harfit"
- d. "Divani" i Nezim Frakullës

**2. Cilat nga këto vepra janë të autorit Jeronim de Rada?**

- a. "Kënga e sprasme e Balës"
- b. "Rrëfime të Arbrit"
- c. "Parimet e estetikës"
- ç. "Këngëtorja arbërore"

**3. Cilat nga llojet e mëposhtme letrare shkruhen në prozë?**

- a. Lirika
- b. Romani
- c. Drama
- ç. Tregimi

**Shembuj të pyetjeve nga testi pranues i Programit BA Gjuhë shqipe**

**1. Cili është libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe dhe kur daton?**

**2. Lako emrin lis në trajtën e pashqar, numri njëjës.**

**3. Si e bëjnë shumësin emrat e mëposhtem:**

student - \_\_\_\_\_

plak - \_\_\_\_\_

laps - \_\_\_\_\_

# MODELE TË PYETJEVE

## **Gjuhë dhe Letërsi Angleze, nga Gjuha angleze (me shkrim);**

Test i bazuar në njohuri gjuhësore të gjuhës angleze.

## **Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, nga Gjuha gjermane (me shkrim);**

Provimi pranues ka për qëllim vlerësimin e njohurive në gjuhën gjermane, përkatësisht në gramatikë, fjalor, përdorim të saktë të strukturave gjuhësore dhe lexim-kuptim.

1. Testi përbëhet nga 50 pyetje me alternativa dhe vlerësohet me gjithsej 100 pikë. Pyetjet mund të përfshijnë ushtrime për fjalë me kuptim të kundërt, fjalë pyetëse, parashtesa të foljeve, parafjalë dhe nyje, përemra, identifikim të gabimeve në fjali, lexim-kuptim dhe plotësim të fjalëve që mungojnë në tekst.

## **Gjuhë dhe Letërsi Frënge, nga Gjuha frënge (me shkrim);**

Test i bazuar në njohuri gjuhësore të gjuhës frënge.

## **Gjuhës dhe Letërsisë Turke, nga Gjuha turke (me shkrim):**

Njohuri themelore për tipologjinë e gjuhës turke, gramatikën e gjuhës turke dhe letërsinë turke.

Programin e Orientalistikës provimi pranues mbahet në formë testi nga këto lëmi:

Gjuhë turke dhe arabe (njohuri elementare), Qytetërim islam, kulturë orientale (me shkrim);

## **Programi i Gazetarisë**

Provimi pranues për kandidatët që aplikojnë në Departamentin e Gazetarisë ndërtohet duke u bazuar në njohuritë dhe kompetencat që maturantët fitojnë gjatë arsimit parauniversitar. Testi synon të vlerësojë përgatitjen e përgjithshme në fushën e gjuhës, letërsisë, edukatës qytetare dhe aftësinë e kandidatëve për të shprehur mendime në mënyrë të argumentuar dhe koherente, përmes eses në fund.

Struktura e testit përbëhet nga katër shtylla kryesore:

- Gjuha shqipe – përfshin pyetje që vlerësojnë njohuritë mbi drejtshkrimin, gramatikën, sintaksën dhe përdorimin e drejtë të gjuhës standarde shqipe.
- Letërsia shqipe – përmban pyetje që matin njohuritë e kandidatëve për autorët, veprat dhe periudhat kryesore të letërsisë shqipe, si dhe aftësinë për interpretimin e teksteve letrare.
- Edukata qytetare – fokusohet në vlerësimin e njohurive bazë mbi qytetarinë demokratike, institucionet, të drejtat dhe përgjegjësitë qytetare, si dhe çështje të interesit publik.
- Eseja – përbën pjesën analitike të testit dhe lidhet me një temë aktuale nga fusha e gazetarisë ose komunikimit. Përmes saj synohet të identifikohen prirjet dhe interesimi i kandidatëve për fushën e studimit, aftësia për të ndërtuar argumente, koherenca dhe kohezioni i tekstit, kultura e të shprehurit, si dhe respektimi i normave të drejtshkrimit dhe gjuhës standarde.

## **Programi i Ballkanistikës**

Test i njohurive gjuhësore për gjuhën shqipe, boshnjake, serbe, kroate dhe malazeze

**Modele të pyetjeve të provimit pranues nga programet e departamenteve respektive:  
Shembull nga testi i Gjuhës gjermane**

I. Wie heißt das Gegenteil?

(0) Beispiel:

Eine Tierart wird bedroht. Eine Tierart wird \_\_\_\_\_ .

a) schützen                      b) schützt                      c) senken                      d) geschützt

die richtige Lösung: d

(1) Ich bin gegen diesen Vorschlag. Ich bin mit diesem Vorschlag \_\_\_\_\_ .

a) versteht                      b) einverstanden  
c) verstanden                      d) verstanden .. ein

(2) Die Kosten für die Folgen der Naturkatastrophen steigen. Die Kosten \_\_\_\_\_ .

a) einverstanden sein                      b) senken  
c) sinken                      d) bleiben

II. Ergänzen Sie das passende Fragewort.

(0) Beispiel: \_\_\_\_\_ wandern Sie am liebsten? – An der Atlantikküste.

a) wo                      b) wie                      c) wohin                      d) was

die richtige Lösung: a

(6) \_\_\_\_\_ haben Sie Ihr Studium abgeschlossen? – 1993.

a) wie                      b) wo                      c) woher                      d) wann

(7) \_\_\_\_\_ arbeiten Sie im Moment? – In einer Apotheke.

a) was                      b) wo                      c) wohin                      d) wann

(8) \_\_\_\_\_ beginnt Ihre Arbeitszeit? – Um 8.30 Uhr.

a) wann                      b) was                      c) wohin                      d) wie

**Shembull nga testi i Ballkanistikës (shqip dhe serbisht)**

Lexoni fjalitë dhe rrethoni formën e saktë (nën a, b ose c):

Gjithsej: \_\_\_\_\_ / 50

1. Kësaj \_\_\_\_\_ i kam qitur ujë. \_\_\_\_\_ / 2

a) lule    b) luleje    c) lules

2. Arta dhe Agimi \_\_\_\_\_ futboll. \_\_\_\_\_ / 2

a) luajnë    b) luan    c) luajmë

3. Dje Gjergji \_\_\_\_\_ në orën 8. \_\_\_\_\_ / 2

a) zgjohet    b) u zgjua    c) zgjohej

4. Kjo është çanta \_\_\_\_\_ ta ka sjellë babai.

\_\_\_ / 2

a) i cili b) së cilës c) që

5. Mirëdita! \_\_\_\_\_ jeni drejtori?

\_\_\_ / 2

a) Ti b) Juve c) Ju

6. Këtë dhuratë e ke nga \_\_\_\_\_.

\_\_\_ / 2

a) unë b) mua c) meje

7. Mësuesja \_\_\_\_\_ caktoi fëmijëve aktivitetet e reja.

\_\_\_ / 2

a) u b) ua c) iu

2. Pažljivo pročitajte rečenice u nastavku i zaokružite slovo ispred tačnog odgovora.

Ukupno bodova: \_\_\_ / 30

1. Marija \_\_\_\_\_ japanski jezik.

\_\_\_ / 1

a) govore b) govorim c) govori

2. Studenti \_\_\_\_\_ muziku.

\_\_\_ / 1

a) slušam b) slušaju c) slušate

3. Ivan \_\_\_\_\_ u 7 sati.

\_\_\_ / 1

a) se bude b) se budim c) se budi

4. Pošli su \_\_\_\_\_ nama.

\_\_\_ / 1

a) prema b) preko c) pored

5. Zdravo, kako si? \_\_\_\_\_, hvala.

\_\_\_ / 1

a) Dobro b) Dobar c) Dobri

6. Uzmi ovaj poklon \_\_\_\_\_ mene.

\_\_\_ / 1

a) iz b) od c) pred

7. Juče \_\_\_\_\_ supruga i ja \_\_\_\_\_ deci igračke.

\_\_\_ / 1

a) kupili; smo b) smo; kupili c) smo; kupile

Shembull nga testi i Gjuhës turke

1. Aşağıdaki tümcenin ek kök tahlili için hangi seçenek doğrudur?

Gözlükçülükten bıkmıştı.

a) Fiil+yapım eki / ad+çekim eki

b) Ad+yapım eki+yapım eki+yapım eki+çekim eki / fiil+çekim eki+çekim eki

c) Ad+yapım eki+yapım eki+çekim eki / fiil+çekim eki

d) Ad+iyelik eki+yapım eki+çekim eki / fiil+çekim eki+çekim eki

# FAKULTETI JURIDIK

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Fillet e së Drejtës, E Drejta Kushtetuese dhe Gjuhë Shqipe. Lëndët në të cilat përpilohen pyetjet e provimeve pranuese në programet programin Bachelor të Fakultetit Juridik janë:

- Fillet e së Drejtës;
- E Drejta Kushtetuese
- Gjuhë Shqipe

## MODELE TË PYETJEVE

### Lënda: Fillet e së Drejtës

Pyetja:

Decentralizimi ka të bëjë me?

- a) Raportin në mes të organeve të të njëjtit nivel të qeverisjes
- b) Raportin në mes të organeve qendrore dhe organeve lokale të pushtetit
- c) Raportin në mes të shtetit dhe institucioneve ndërkombëtare
- d) Raportin në mes të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

### E Drejta Kushtetuese

Pyetja:

Kushtetuta e SHBA-ve ka hyrë në fuqi më 1789 dhe njihet si një?

- a) Kushtetutë e butë
- b) Kushtetutë e fortë
- c) Kushtetutë e përkohshme.
- d) Asnjëra prej tyre

### Gjuhë shqipe

Pyetja:

Cila nga këto shprehje është shkruar drejtë?

- a) Fëmijët shkon në shkollë
- b) Fëmijët shko në shkollë
- c) Fëmijët shkojnë në shkollë
- d) Fëmijët janë shkuar në shkollë.

# FAKULTETI I EKONOMISË

Provimi pranues për departamentet në gjuhën shqipe do të mbahet nga lëndët: Hyrje në ekonomi dhe Matematikë. Provimi pranues për programin Applied Economics and Management (BSc) do të mbahet nga lëndët:

- Hyrje në ekonomi,
- Matematikë dhe
- Gjuhë angleze.

## MODELE TË PYETJEVE

### Matematikë

1. Një mall pas rritjes së çmimit për 15% shitet me çmimin 1748 euro. Sa ishte çmimi i shitjes para rritjes

- a) 1510            b) 1520            c) 1580            d) 1585

2. Zgjidhja e barazimit linear është

- a)                    b)                    c)                    d)  $x=10$

3. Në qoftë se atëherë vlera e është:

- a) 6                    b) 5                    c) 2                    d) 8

4. Zgjidhja e barazimit eksponencial është

- a)                    b)                    c)                    d)  $x=5$

### Hyrje ne Ekonomi

1. Qëllimi i firmës është të:

- Maksimizojë fitimin e firmës
- Maksimizojë shpenzimet e firmës
- Maksimizojë kënaqësinë e punonjësve pavarësisht kostos
- Asnjëra

2. Në ekonominë e tregut, banka qendrore ka këto përgjegjësi ligjore për:

- Mbikëqyrjen e bankave komerciale
- Mbikëqyrjen e firmave prodhuese
- Menaxhimin e ndërmarrjeve private
- Asnjëra

3. Elasticiteti çmimor i kërkesës shpreh shkallën e reagimit të konsumatorit ndaj ndryshimit të:

- kapitalit
- çmimit
- punës
- teknologjisë

4. Gjatë fazës së rritjes ekonomike:

- konsumatorët ulin konsumin
- firmat ulin prodhimin
- rritet numri i të punësuarëve
- zvogëlohen investimet private

# FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT

Testi pranues është zhvilluar përmes sistemit të kodimit, ku secilit kandidat i caktohet një kod unik, duke garantuar anonimitetin gjatë procesit të vlerësimit. Pas përfundimit të kontrollimit të testeve dhe regjistrimit të pikëve nga provimi pranues, bëhet hapja e kodeve dhe identifikimi i kandidatëve. Rezultati përfundimtar llogaritet duke mbledhur pikët e fituara në provimin pranues me pikët nga suksesi në shkollën e mesme dhe rezultatet e Testit të Maturës Shtetërore. Në bazë të këtyre rezultateve hartohet lista përfundimtare e kandidatëve.

Provimi pranues do të mbahet nga lënda:

- Matematikë

## MODELE TË PYETJEVE

1.	<i>Ekuacioni i drejtëzës e cila kalon nëpër pikat <math>A(-1,2)</math>, <math>B(0,-3)</math>, është:</i>	a) $y = -5x - 3$	b) $y = -5x + 3$
		c) $y = 5x - 3$	ç) $y = 5x + 3$
2.	<i>Zgjidhja e ekuacionit</i> $\frac{\frac{x}{2} + 1}{\frac{x}{3} - 1} = \frac{\frac{x}{4} + 1}{\frac{x}{6} - \frac{3}{8}},$ është	a) $x = \frac{1}{6}$	b) $x = -\frac{1}{6}$
		c) $x = 6$	ç) $x = -6$
3.	<i>Të thjeshtohet shprehja:</i> $\frac{1 + a + \frac{1}{1-a}}{1 + \frac{1}{1-a^2}}$	a) $\frac{a+1}{a^2+1}$	b) $a+1$
		c) $a^2+1$	ç) $\frac{a^2+1}{a+1}$

# FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE

Testi pranues për regjistrim në studimet Baçelor në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) zhvillohet në **lëndën e Matematikës**, zgjat 120 minuta dhe është i njëjtë për kandidatët e të gjitha programeve të studimit të FIEK-ut.

Testi përmban 20 detyra me alternativa. Secila detyrë shoqërohet me katër alternativa përgjigjesh (a, b, c dhe d), nga të cilat vetëm njëra është e saktë. Kandidatët duhet të paraqesin zgjidhjen e plotë në fletoren e provimit dhe më pas të zgjedhin alternativën që konsiderojnë të saktë. Përgjigjja vlerësohet si e saktë vetëm nëse alternativa e përzgjedhur përputhet me zgjidhjen e paraqitur në fletoren e provimit.

Pyetjet e testit përfshijnë detyra nga matematika e shkollës së mesme, duke përfshirë shprehjet numerike dhe algjebrike, ekuacionet, sistemet e ekuacioneve, inekuacionet, trigonometrinë, vargjet aritmetike dhe gjeometrike, gjeometrinë analitike dhe matematikën logjike. Të gjitha detyrat vlerësohen me numër të njëjtë pikësh dhe për përgjigjet e pasakta nuk aplikohen pikë negative.

# MODELE TË PYETJEVE

1	Të thjeshtohet shprehja $\left(\frac{a+b}{a-b}\right)^3 \cdot \left(\frac{a-b}{a+b}\right)^5 : \left(\frac{a-b}{a+b}\right)^{-4}$	a	$\left(\frac{a+b}{a-b}\right)^2$	c	$\left(\frac{a-b}{a+b}\right)^3$
		b	$\left(\frac{a+b}{a-b}\right)^3$	d	$\left(\frac{a-b}{a+b}\right)^2$
2	Zgjidhje e ekuacionit $\frac{3x-1}{3x+1} + \frac{x-3}{x+3} = 2$ është:	a	$x = -\frac{3}{5}$	c	$x = -\frac{5}{3}$
		b	$x = \frac{3}{5}$	d	$x = \frac{5}{3}$
3	Zgjidhje të ekuacionit kuadratik $\frac{x^2+1}{6} - \frac{(x+2)(x-1)}{4} - \frac{5}{2} = \frac{x-3}{3}$ janë:	a	$x_1 = -2, x_2 = -5$	c	$x_1 = -2, x_2 = 5$
		b	$x_1 = 2, x_2 = 5$	d	$x_1 = 2, x_2 = -5$
4	Zgjidhje të ekuacionit $\left 3x + \frac{1}{4}\right  = 2$ janë:	a	$x = \frac{7}{12}, x = -\frac{3}{4}$	c	$x = -\frac{7}{12}, x = -\frac{3}{4}$
		b	$x = -\frac{7}{12}, x = \frac{3}{4}$	d	$x = \frac{7}{12}, x = \frac{3}{4}$
5	Zgjidhje e ekuacionit irracional $\sqrt{x^2 - 5x + 2} = x + 3$ është:	a	$x = -\frac{7}{11}$	c	$x = \frac{11}{7}$
		b	$x = \frac{7}{11}$	d	$x = -\frac{11}{7}$
6	Nëse $a = 2^{30}, b = 8^8$ dhe $c = 4^{11}$ , cili nga jobarazimet është i saktë?	a	$c < b < a$	c	$a < b < c$
		b	$c < a < b$	d	$b < a < c$
7	Zgjidhje e ekuacionit eksponencial $\left(\frac{16}{9}\right)^{5-2x} = \frac{64}{27}$ është:	a	$x = \frac{7}{4}$	c	$x = 1$
		b	$x = \frac{7}{2}$	d	$x = \frac{5}{4}$
8	Zgjidhjet e ekuacionit logaritmik $\log(x-1) + \log(x-2) = \log 6 + \log(x-3)$ janë:	a	$x_1 = 4, x_2 = 5$	c	$x_1 = 5, x_2 = 6$
		b	$x_1 = 4, x_2 = 6$	d	$x_1 = 5, x_2 = 7$
9	Zgjidhja e sistemit të ekuacioneve $\begin{cases} \frac{2}{5x} + \frac{5}{3y} = 7 \\ \frac{1}{10x} - \frac{7}{6y} = -3 \end{cases}$ është:	a	$x = \frac{1}{5}, y = \frac{1}{3}$	c	$x = -\frac{1}{5}, y = \frac{1}{3}$
		b	$x = \frac{2}{5}, y = \frac{5}{3}$	d	$x = -\frac{2}{5}, y = \frac{5}{3}$
10	Bashkësia e zgjidhjeve të inekuacionit $\frac{x-2}{4x-5} \leq 0$ është:	a	$x \in \left(\frac{5}{4}, 2\right]$	c	$x \in \left[\frac{5}{4}, 2\right)$
		b	$x \in \left(\frac{5}{4}, 2\right)$	d	$x \in \left[\frac{5}{4}, 2\right)$

# MODELE TË PYETJEVE

11	Bashkësia e zgjidhjeve të inekuacionit $ x^2 - x - 3  \geq 9$ është:	a	$x \in (-\infty, -3] \cup [4, \infty)$	c	$x \in (-\infty, -3]$
		b	$x \in [4, \infty)$	d	$x \in [-3, 4]$
12	Vlera e shprehjes $\frac{2 \cos^2 \alpha - 1}{\sin \alpha \cos \alpha}$ është:	a	$\operatorname{ctg} \alpha - \operatorname{tg} \alpha$	c	$\cos \alpha - \sin \alpha$
		b	$\operatorname{tg} \alpha + \operatorname{ctg} \alpha$	d	$\sin \alpha + \cos \alpha$
13	Zgjidhjet e ekuacionit trigonometrik $\sin^2 x + \frac{1}{2} \sin 2x = 1$ në intervalin $[0, 2\pi]$ janë:	a	$\frac{\pi}{4}, \frac{\pi}{2}, \frac{5\pi}{4}, \frac{3\pi}{2}$	c	$\frac{\pi}{2}, \pi, \frac{3\pi}{2}$
		b	$\frac{\pi}{4}, \pi, \frac{5\pi}{4}$	d	$\frac{3\pi}{4}, \pi, \frac{5\pi}{4}, \frac{3\pi}{2}$
14	Diagonalja e drejtkëndëshit është $d = 13 \text{ cm}$ , ndërsa syprina e tij është $S = 60 \text{ cm}^2$ . Brinjët e tij janë:	a	$a = 5 \text{ cm}, b = 12 \text{ cm}$	c	$a = 4 \text{ cm}, b = 15 \text{ cm}$
		b	$a = 6 \text{ cm}, b = 10 \text{ cm}$	d	$a = 3 \text{ cm}, b = 20 \text{ cm}$
15	Në trekëndëshin kënddrejtë njëra katete është $25 \text{ cm}$ ndërsa hipotenuza është për $15 \text{ cm}$ më e madhe se kateta tjetër. Të caktohet vlera e hipotenuzës dhe katetës tjetër.	a	$a = \frac{40}{3}, c = \frac{85}{3}$	c	$a = \frac{40}{6}, c = \frac{85}{6}$
		b	$a = \frac{45}{3}, c = \frac{85}{3}$	d	$a = \frac{45}{6}, c = \frac{85}{3}$
16	Njëra brinjë e katrorit është zvogëluar për $m$ ndërsa brinja tjetër është rritur për $m$ , duke formuar një drejtkëndësh. Syprina e drejtkëndëshit të formuar është për $49$ më e vogël se ajo e katrorit. Sa është vlera $m$ -së?	a	7	c	9
		b	8	d	6
17	Pikëprerjet e rrethit $(x - 1)^2 + y^2 = 1$ me drejtëzën $-x + y + 2 = 0$ janë:	a	$A(2,0) B(1,-1)$	c	$A(-2,0) B(1,1)$
		b	$A(2,0) B(1,1)$	d	$A(-2,0) B(1,-1)$
18	Beni mori 40% të një torte. Ndërsa Ana mori 50% të tortës së mbetur. Sa përqind e tortës mbeti nga pjesa origjinale?	a	30%	c	40%
		b	10%	d	20%
19	Zana u shëtiti në male për 5 ditë. Ajo filloi të hënën dhe përfundoi të premten. Çdo ditë ajo e ecte 2 km më shumë se sa ditën e kaluar. Kur shëtitja përfundoi distanca që ajo kishte kaluar ishte 70 km. Sa kilometra kishte ecur Zana ditën e premte?	a	18 km	c	20 km
		b	14 km	d	16 km
20	Një lule ka katër petale. Sa herë që bie një petale, pesë petale të reja rriten. Nëse bien gjashtë petale një nga një, sa petale do të ketë lulja në fund?	a	28	c	24
		b	26	d	32

# FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Testi pranues për studimet Baçelor në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike do të zhvillohet në lëndën e Matematikës.

Kandidatët duhet të paraqiten në kohën e caktuar dhe të kenë me vete një dokument valid identifikimi.

Testi do të administrohet sipas rregullave të njësisë akademike, duke siguruar kushte të barabarta për të gjithë kandidatët. Kandidatët këshillohen të paraqiten të paktën 15 minuta para fillimit të testit për verifikimin e identitetit dhe sistemimin në sallë.

## MODELE TË PYETJEVE

<p>Të drejtshkruarët për shatëz tërëz <math>a = 8 \text{ cm}</math> dhe diagonale <math>d = 10 \text{ cm}</math>.</p> <p>Të sqarohen parametrat e drejtshkruarëve:</p>	A	$P = 22 \text{ cm}$
	B	$P = 24 \text{ cm}$
	C	$P = 26 \text{ cm}$
	D	$P = 28 \text{ cm}$
<p>Të thjeshtohet shprehja</p> $\frac{x-3}{x^2-25} - \frac{3x^2-9x}{x-5}$	A	$\frac{x+5}{3}$
	B	$3x(x+5)$
	C	$\frac{1}{3x(x+5)}$
	D	$\frac{3x}{x+5}$
<p>Të sqarohen koeficientët <math>a_1</math> dhe <math>b_1</math> të rrezeve gjenerale, nëse për shatëz:</p> $a_1 = -10, b_1 = -2$	A	$a_1 = 2, b_1 = -10$
	B	$a_1 = 2, b_1 = 10$
	C	$a_1 = -2, b_1 = 10$
	D	$a_1 = -2, b_1 = -10$

# FAKULTETI I MJEKËSISË

Provimi pranues në Fakultetin e Mjekësisë zhvillohet nga lëndët:

- Kimi
- Biologji

## Vlerësimi i testit pranues

**Për kandidatët që posedojnë rezultat nga Provimi i Maturës Shtetërore, vlerësimi i testit pranues bëhet sipas kësaj skeme:**

- përgjigjja e saktë vlerësohet me plus zero pikë tetë (+0.8);
- përgjigjja e pasaktë vlerësohet me minus zero pikë njëzet e gjashtë (-0.26);
- dy ose më shumë përgjigje të shënuara në të njëjtën pyetje vlerësohen me minus zero pikë njëzet e gjashtë (-0.26);
- pyetja pa përgjigje nuk sjell pikë.

**Për kandidatët që nuk posedojnë rezultat nga Provimi i Maturës Shtetërore, vlerësimi i testit pranues bëhet sipas kësaj skeme:**

- përgjigjja e saktë vlerësohet me plus një pikë katër (+1.4);
- përgjigjja e pasaktë vlerësohet me minus zero pikë dyzet e gjashtë (-0.46);
- dy ose më shumë përgjigje të shënuara në të njëjtën pyetje vlerësohen me minus zero pikë dyzet e gjashtë (-0.46);
- pyetja pa përgjigje nuk sjell pikë.

**Për kandidatët e programeve Bachelor në Infermieri dhe Bachelor në Fizioterapi nuk zbatohet vlerësimi me pikë negative.**

1. Për kandidatët e përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni:
  - përgjigjja e saktë vlerësohet me pikë pozitive sipas skemës së miratuar nga Fakulteti;
  - përgjigjja e pasaktë nuk sjell pikë;
  - pyetja pa përgjigje nuk sjell pikë;
  - shënimi i dy ose më shumë përgjigjeve në të njëjtën pyetje konsiderohet përgjigje e pasaktë dhe nuk sjell pikë.

## Organizimi i testit pranues në studimet bachelor dhe të integruara

1. Testi pranues për studimet bachelor dhe studimet e integruara në Fakultetin e Mjekësisë zgjat nëntëdhjetë (90) minuta.
2. Gjatë zhvillimit të testit pranues sigurohet ambient i kontrolluar dhe i standardizuar për të gjithë kandidatët, në përputhje me parimet e barazisë, transparencës dhe integritetit të procesit.
3. Për të garantuar mbarëvajtjen e procesit dhe parandalimin e çdo forme të komunikimit të jashtëm elektronik, në objektet ku mbahet testi aktivizohen pajisje për bllokimin e sinjaleve të telefonisë mobile dhe internetit (zhurmues/sisteme të pengimit të sinjalit), në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Në çdo sallë ku zhvillohet testi pranues caktohen kujdestarë të provimit të përbërë nga staf akademik i Fakultetit të Mjekësisë, të cilët janë përgjegjës për:
  - mbikëqyrjen e rregullit gjatë testit;
  - identifikimin e kandidatëve (dokument valid, identifikimi me fotografi);
  - zbatimin e rregullave të provimit;
  - raportimin e çdo parregullsie Komisionit për Provim Pranues.


**Kandidati që përdor mjete të palejuara, posedon pajisje elektronike, komunikon me kandidatë të tjerë, kopjon ose tenton të ndikojë në procesin e testimit, largohet nga provimi dhe testi i tij shpallet i pavlefshëm.**

# MODELE TË PYETJEVE

1. Nëse të dyja alelet e një gjeni të caktuar të një individi janë të njëjta, ai individ për atë gjen është

- a. Heterozigot
- b. Homozigot
- c. Hemizigot
- d. Dizigot

2. Sa gram oksid magnezi fitohen gjatë djegies së 2 g magnez në ajër sipas reaksionit:



- a. 3.3 g
- b. 33 g
- c. 1.6 g
- d. 16 g

3. Sa është numri i izomerëve vargorë të heksanit,  $\text{C}_6\text{H}_{14}$ ?

- a. 4
- b. 5
- c. 6
- d. 7

# FAKULTETI I ARTEVE

Provimi pranues në Fakultetin e Arteve organizohet në përputhje me natyrën specifike të programeve studimore dhe ka për qëllim vlerësimin e talentit artistik, kreativitetit, potencialit krijues, njohurive bazë profesionale dhe aftësive praktike të kandidatëve.

Për dallim nga njësitë e tjera akademike, vlerësimi në Fakultetin e Arteve realizohet përmes kombinimit të testeve praktike, detyrave krijuese, performancave artistike, prezantimit të portfoliove, intervistave dhe formave të tjera të vlerësimit që lidhen drejtpërdrejt me kompetencat hyrëse të programit përkatës.

Provimi pranues zhvillohet sipas kriterëve dhe fazave të përcaktuara nga departamentet përkatëse, duke siguruar vlerësim objektiv, transparent dhe meritokratik të kandidatëve. Kriteret, detyrat, materialet e nevojshme, mënyra e pikëzimit dhe procedurat e vlerësimit publikohen paraprakisht dhe janë të harmonizuara me kërkesat e secilit program studimor.

Në kuadër të Fakultetit të Arteve, organizimi i provimit pranues realizohet sipas specifikave të:

- Departamentit të Arteve të Bukura;
- Departamentit të Arteve Muzikore;
- Departamentit të Arteve Dramatike.

Për secilin departament dhe specializim zbatohen kriteret e veçanta të paraqitura në vijim.

## **Kërkesat dhe fazat e provimit pranues sipas specializimeve në Departamentin e Arteve të Bukura/Programi i Arteve Vizuale**

Studentët të cilët konkurojnë në njërin prej Specializimeve të Departamentit të Arteve të Bukura, Programi i Arteve Vizuale, duhet tu nënshtrohen kriterëve në vijim:

### **SPECIALIZIMI: PIKTURË**

#### **Faza e parë:**

##### **Provimi në vizatim:**

Kandidatët do të vizatojnë portretin dhe figurën njerëzore duke u bazuar në modelin e gjallë.

(Materialet që studentët duhet të sjellin me vete në ditën e provimit):

Një pako letre ose kartoni (përmasa minimale 50cm x 70cm).

Lapsa, thëngjill dhe mjete të tjera për vizatim.

#### **Faza e dytë:**

##### **Provimi në pikturë:**

Kandidatët do të realizojnë një detyrë në pikturë.

(Materialet që studentët duhet të sjellin me vete në ditën e provimit):

Një pëlhurë (50cm x 70cm).

Ngjyra vaji ose akrilik dhe mjete për pikturë.

#### **Faza e tretë:**

##### **Interivista dhe prezantimi i portfolios:**

Kandidatët do të paraqesin portfolion e tyre dhe do të intervistohen lidhur me punën e tyre krijuese, procesin krijues dhe vizionin artistik.

(Kërkesat për Portfolion):

##### **Portfolio fizike:**

Përmbajtja: 15 vepra origjinale (5 vizatime, 5 piktura, 5 skica konceptuale)/ Formati: A3

Vërejtje: Dorëzohet dhe prezantohet gjatë intervistës

##### **Portfolio digjitale:**

Përmbajtja:

- Të njëjtat 15 vepra origjinale si në portfolion fizike.
- Skicat fillestare për të dokumentuar procesin krijues.
- Një ese prej 400 fjalësh me temën: “Cili është këndvështrimi juaj për rëndësinë e artit në shoqërinë bashkëkohore?”

Dorëzimi: Duhet të dërgohet në adresën [artevizuale@uni-pr.edu](mailto:artevizuale@uni-pr.edu) gjatë aplikimit.

#### **Ese:**

Një ese prej 400 fjalësh me temën: “Cili është këndvështrimi juaj për rëndësinë e artit në shoqërinë bashkëkohore?”

# FAKULTETI I ARTEVE

## SPECIALIZIMI: GRAFIKË

### Faza e parë:

#### Provimi në vizatim:

Kandidatët do të vizatojnë portretin dhe figurën njerëzore duke u bazuar në modelin e gjallë.

(Materialet që studentët duhet të sjellin me vete në ditën e provimit):

Një pako letre ose kartoni (përmasa minimale 50cm x 70cm).

Lapsa, thëngjill dhe mjete të tjera për vizatim.

### Faza e dytë:

#### Provimi në grafikë:

Kandidatët do të realizojnë një detyrë kreative në fushën e grafikës.

(Materialet që studentët duhet t'i sjellin me vete në ditën e provimit):

Karton (përmasa minimale 50cm x 70cm).

Ngjyra, tush, dhe materiale të tjera përkatëse për grafikë.

### Faza e tretë:

#### Intervista dhe prezantimi i portfolios:

Kandidatët do të paraqesin portfolion e tyre dhe do të intervistohen lidhur me punën e tyre krijuese, procesin krijues dhe vizionin artistik.

(Kërkesat për portfolion):

#### Portfolio fizike:

Përmbajtja: 15 vepra origjinale (5 vizatime, 5 grafika, 5 skica konceptuale)/ Formati: A3

Vërejtje: Dorëzohet dhe prezantohet gjatë intervistës

#### Portfolio digjitale:

Përmbajtja:

- Të njëjtat 15 vepra origjinale si në portfolion fizike.
- Skicat fillestare për të dokumentuar procesin krijues.
- Një ese prej 400 fjalësh me temën: "Cili është këndvështrimi juaj për rëndësinë e artit në shoqërinë bashkëkohore?"

Dorëzimi: Duhet të dërgohet në adresën [artvizuale@uni-pr.edu](mailto:artvizuale@uni-pr.edu) gjatë aplikimit.

# FAKULTETI I ARTEVE

## SPECIALIZIMI: SKULPTURË

### Faza e parë:

#### Provimi në vizatim:

Kandidatët do të vizatojnë portretin dhe figurën njerëzore duke u bazuar në modelin e gjallë.

(Materialet që studentët duhet të sjellin me vete në ditën e provimit):

Një pako letre ose kartoni (përmasa minimale 50cm x 70cm).

Lapsa, thëngjill dhe mjete të tjera për vizatim.

### Faza e dytë:

#### Provimi në skulpturë:

Kandidatët do të realizojnë një detyrë në skulpturë duke përdorur materialet e ofruara nga Fakulteti.

(Materialet e ofruara nga Fakulteti):

Të gjitha materialet e nevojshme për provimin e Skulpturës.

### Faza e tretë:

#### Interivista dhe prezantimi i portfolios:

Kandidatët do të paraqesin portfolion e tyre dhe do të intervistohen lidhur me punën e tyre krijuese, procesin krijues dhe vizionin artistik.

(Kërkesat për Portfolion):

#### Portfolio fizike:

Përmbajtja: 15 vepra origjinale (10 vizatime, 5 skica konceptuale)/ Formati: A3

Vërejtje: Dorëzohet dhe prezantohet gjatë intervistës

#### Portfolio digjitale:

Përmbajtja:

- Të njëjtat 15 vepra origjinale si në portfolion fizike.
- Skicat fillestare për të dokumentuar procesin krijues.
- Një ese prej 400 fjalësh me temën: "Cili është këndvështrimi juaj për rëndësinë e artit në shoqërinë bashkëkohore?"

Dorëzimi: Duhet të dërgohet në adresën [artevizuale@uni-pr.edu](mailto:artevizuale@uni-pr.edu) gjatë aplikimit.

# FAKULTETI I ARTEVE

## SPECIALIZIMI: ILUSTRIM DHE VIZATIM

### Faza e parë:

#### Provimi në vizatim:

Kandidatët do të vizatojnë portretin dhe figurën njerëzore duke u bazuar në modelin e gjallë.

(Materialet që studentët duhet të sjellin me vete në ditën e provimit):

Vizatim: Një pako me letër ose karton (madhësia minimale 50cm x 70cm), lapsa, qymyr, dhe materiale të tjera për vizatim.

### Ese:

Kandidatët duhet të shkruajnë gjatë provimit një ese prej 400 fjalësh për të dëshmuar njohuritë e tyre artistike.

(Materialet që studentët duhet të sjellin me vete në ditën e provimit):

Ese: Letër të bardhë A4, laps

### Faza e dytë:

#### Provimi në ilustrim:

Kandidatët i nënshtrohen një provimi në lëndën e ilustrimit duke përfunduar një detyrë krijuese.

(Materialet që studentët duhet të sjellin me vete në ditën e provimit):

Një karton (madhësia minimale 50cm x 70cm) dhe ngjyrat e dëshiruara. Studentët janë të lirë të aplikojnë teknika të ndryshme dhe të përdorin materiale sipas zgjedhjes së tyre (kolazh, ngjyra sipas zgjedhjes së tyre, lapsa me ngjyra, akuarel, markerë, etj).

### Faza e tretë:

#### Interivista dhe prezantimi i portfolios:

Kandidatët do të paraqesin portfolion e tyre dhe do të intervistohen lidhur me punën e tyre krijuese, procesin krijues dhe vizionin artistik

(Kërkesat për Portfolion):

#### Portfolio fizike:

Përmbajtja: 15 vepra origjinale (5 vizatime, 5 ilustrime, 5 skica konceptuale)/ Formati: A3

Vërejtje: Dorëzohet dhe prezantohet gjatë intervistës

#### Portfolio digjitale:

Përmbajtja:

- Të njëjtat 15 vepra origjinale si në portfolion fizike.
- Skicat fillestare për të dokumentuar procesin krijues.

Dorëzimi: Duhet të dërgohet në adresën [artevizuale@uni-pr.edu](mailto:artevizuale@uni-pr.edu) gjatë aplikimit.

# FAKULTETI I ARTEVE

## SPECIALIZIMI: ART KONCEPTUAL DHE MEDIA TË REJA

### Faza e parë:

#### Provimi në art konceptual dhe media të reja:

Kandidatët i nënshtrohen një provimi në lëndën e artit konceptual dhe mediave të reja për të dëshmuar aftësitë e tyre artistike.

(Materialet që studentët duhet të sjellin me vete në ditën e provimit):

Punë artistike: Një pako letër (madhësia minimale 50cm x 70cm), lapsa, thëngjill dhe ngjyrat që i preferojnë.

### Faza e dytë:

#### Ese:

Kandidatët duhet të shkruajnë gjatë provimit një ese prej 400 fjalësh për të vlerësuar njohuritë dhe perspektivën e tyre mbi artin.

(Materialet që studentët duhet të sjellin me vete në ditën e provimit):

Ese: Letër të bardhë A4, laps

### Faza e tretë:

#### Interivista dhe prezantimi i portfolios:

Kandidatët do të prezantojnë portfolion e tyre dhe do të intervistohen për të diskutuar punimet, procesin krijues dhe vizionin e tyre artistik. Portfoli duhet të demonstrojë një gamë aftësish dhe të përfshijë skica fillestare për të dokumentuar zhvillimin e ideve të tyre.

(Kërkesat për Portfolion):

Portfolio fizike:

Përmbajtja: 15 vepra origjinale (Fotografi, video, instalacione, ndërhyrje artistike ose skica konceptuale)/ Formati: A3

Vërejtje: Dorëzohet dhe prezantohet gjatë intervistës

Portfolio digjitale:

Përmbajtja:

- Të njëjtat 15 vepra origjinale si në portfolion fizike.
- Skicat fillestare për të dokumentuar procesin krijues.

Dorëzimi: Duhet të dërgohet në adresën [artevizuale@uni-pr.edu](mailto:artevizuale@uni-pr.edu) gjatë aplikimit.

# FAKULTETI I ARTEVE

## SPECIALIZIMI: DIZAJN GRAFIK DHE MULTIMEDIA

### Intervista:

1. Prezantimi i shkurtër i kandidatit/tes (Bio): Një përshkrim i përgjithshëm dhe i strukturuar i historikut profesional dhe akademik të kandidatëve, duke përfshirë projektet e mëparshme, aftësitë dhe eksperiencat relevante në fushën e dizajnit grafik dhe multimedias.
2. Arsyet për zgjedhjen e studimeve në specializimin "Dizajn Grafik dhe Multimedia": Kandidati/ja duhet të shpjegojë arsyet përse ka zgjedhur të ndjeku programin e studimeve bachelor në këtë fushë, si dhe synimet që ka për zhvillimin e aftësive të tij/saj në të ardhmen.
3. Motivet që qëndrojnë pas zgjedhjes për të studiuar "Dizajn Grafik dhe Multimedia": Diskutimi i faktorëve personal dhe profesional që kanë nxitur kandidatin të zgjedhë këtë fushë, dhe pse programi e studimeve bachelor është hapi i duhur për zhvillimin e mëtejshëm të tij/saj.
4. Shpjegimi i konceptit të punuar në fazën I: Kandidati/ja duhet të shpjegojë në detaje konceptin e zhvilluar gjatë fazës së parë të provimit, duke përfshirë procesin krijues, metodat e përdorura dhe implementimin e ideve të tij/saj.
5. Prezantimi i portfolios dhe vizioni për zhvillimin krijues të aftësive të ardhshme: Kandidati/ja duhet të prezantojë portfolion e tij/saj dhe të diskutojë mënyrën se si e sheh zhvillimin e aftësive krijuese në të ardhmen, duke përfshirë qëllimet për avancimin e teknikave dhe eksperimentimin me stilin dhe mediat e reja.
6. Preferencat për mediumet e artit dhe dizajnit, pasionet jashtë studimeve dhe burimet e inspirimit: Kandidati/ja mund të diskutojë mediumet që i preferon për krijimin e artit dhe dizajnit, pasionet jashtë studimeve dhe faktorët që e frymëzojnë dhe motivojnë për të krijuar punime të reja.

### Portfolio fizike:

Portfolio fizike me punime të avancuara të kandidatëve duhet të dorëzohet gjatë intervistës (jo më shumë se 10 punime). Portfolio duhet të jetë në format A3 Portret dhe të përmbajë punime që reflektojnë aftësitë e zhvilluara dhe punë origjinale tëkandidatëve.

### Portfolio digjitale dhe biografia:

Portfolio digjitale duhet të përmbajë portfolion e prezantuar në intervistë dhe një biografi të shkurtër (deri në 300 fjalë) që shpjegon rrugëtimin profesional dhe akademik të kandidatëve. Portfolio digjital mund të përfshijë edhe punime dhe projekte të mëparshme që tregojnë aftësitë dhe vizionin e kandidatit. Portfolio digjitale dhe biografia duhet të ngarkohen në një platformë (shembuj: Wetransfer, Google Drive, Dropbox, etj.) dhe të dërgohen në email: arte@uni-pr.edu.

# FAKULTETI I ARTEVE

## DEPARTAMENTI I MUZIKËS

### KRITERET E PROVIMIT PRANUES NË NIVELIN BACHELOR

#### Programi i studimit : BACHELOR I MUZIKËS NË PEFORMIM

Vlerësimi i provimit pranues sipas këtyre kriterëve - BACHELOR

-Deri në 60% pikëve arrihet: - (30% mesatarja e suksesit të shkollës së mesme dhe 30% i pikëve nga provimi i maturës)  
-Deri në 40 % të pikëve nga provimi pranues (instrumentistet: instrumenti 20%, solfezh 10% dhe teori të muzikës 10% ; solo-këndim: 20%- solo kendim; solfezh dhe teori të muzikës 10% dhe piano obligat 10%; dirigjim: 20%, harmoni dhe polifoni 10% dhe piano 10%; kompozim 20%, harmoni dhe polifoni 10% dhe piano 10%)

#### Specializimi PIANO

·Provim nga lënda PIANO (a)J. S. Bach - 1 Prelud dhe Fugë nga WTC b)1 Vepër virtuoze; c) 1 Sonatë klasike ( Beethoven, një kohë); d)1 Vepër madhore romantike;

·Provim nga lënda: SOLFEZH;

·Provim nga lënda TEORI E MUZIKËS;

#### Specializimi: INSTRUMENTET ME HARQË DHE TELA

· Provim nga instrumenti harkor përkatës (a) J. S. Bach - 1 Kohë nga Suita / Partita; b)1 Koncert ( një kohë ); c)1 Sonatë ( një kohë ); d) 1 Pjesë virtuoze;

- KITARA a) 2 kohë nga suitat e Bach-ut ( nga suitat për çello ose flaut); b) F. SOR – 1 etidë nga op.6.dhe 29; c) 1 etidë përzgjedhje; d) 1 vepër ciklike:

· Provim nga lënda: SOLFEZH

· Provim nga lënda: TEORI e MUZIKËS

#### Specializimi: INSTRUMENTET FRYMORE

· Provim nga lënda e instrumenti frymor përkatës ( a) 1 Koncert (komplet); b) 1 Sonatë (komplet); c) 1Pjesë virtuoze; )

· Promin nga lënda: SOLFEZH

· Provim nga lënda: TEORI e MUZIKËS

#### Specializimi SOLO KËNDIM

·Provim nga SOLO KËNDIMI ( a) 2 Arie ( nga repertuori operistik );b) 2 Këngë solo ( në cilndo gjuhë );

·Provim nga lëndët: SOLFEZH - TEORI e MUZIKËS

·Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT

#### Specializimi: DIRIGJIM

· Dirigjim i veprës për orkestër, për solist ose vokalo instrumentale; ( dirigjim publik ose DVD)

Incizimi duhet të fokusohet në fytyrë (profil)dhe në lëvizjet e duarve të kandidatit, si dhe mundësisht edhe të një pjese të orkestrës.

Incizimi duhet të dorëzohet së paku dy ditë para provimit.

·Provim nga lënda: SOLFEZH

·Provim nga lënda: HARMONI

·Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT

#### Programi i studimit - BACHELOR I MUZIKËS

##### Specializimi: KOMPOZIM

·Prezentimi i 3 kompozimeve të dorëzuara;

·Provim nga lënda: SOLFEZH

·Provim nga lëndët: HARMONI - POLIFONI

·Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT

# FAKULTETI I ARTEVE

## DEPARTAMENTI I ARTEVE DRAMATIKE

### KRITERET E PROVIMIT PRANUES NË NIVELIN BACHELOR:

#### Programi i Arteve Dramatike

Për verifikimin e aftësive të veçanta, kandidatët do të japin këto provime:

#### Specializimi: Aktrim

Pjesa e parë e programit eliminues:

- Një recitim i një poezie (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Një monolog dramaturgjia e autorëve- dramaturgëve botërorë dhe kombëtarë (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Një tregim i shkurtër popullor (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Një këngë;
- Një imitim.

Kandidati është i obliguar që t'i mësojë përmendësh dhe t'i përgatisë detyrat. Komisioni, pas programit të shfaqur, mund t'i shtojë kandidatit edhe detyra plotësuese (improvizime), për të fituar bindje sa më të plotë për aftësitë e kandidatit.

Pjesa e dytë e programit eliminues:

- Puna me mësimdhënës të caktuar,
- Verifikimi përfundimtar i aftësive.
- Të gjithë aplikantët luten të sjellin fotografi "bust" në ditën e aplikimit.

#### Specializimi: Regji Teatri

Kandidatët duhet të sjellin një koncept regjisorial për inskenimin e një shfaqje, me skica për hapësirë skenike.

Provimi pranues zhvillohet në dy pjesë:

Pjesa e parë e provimit përbëhet nga vlerësimi i punimeve të sjella dhe vlerësimi i kulturës së përgjithshme të kandidatit, ndërsa pjesa e dytë e provimit pranues (për kandidatët të cilët e kalojnë pjesën e parë të provimit) përbëhet nga inskenimi i një situatë nga një dramë e përcaktuar nga komisioni vlerësues.

#### Specializimi: Regji Filmi dhe Televizioni

Kandidatët që konkurrojnë në Regji Filmi duhet t'i nënshtrohen testit me pyetje të kulturës së përgjithshme, në veçanti nga arti dhe kryesisht nga filmi.

Sinopsis me shkrim në temën e dhënë në pjesën e parë të provimit. Tema jepet menjëherë pas testit në provim.

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e dytë, i mbrojnë para komisionit punimet e veta.

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e tretë, janë të detyruar të gjirojnë vetë në temën e dhënë (film tre minutash), të cilin e shfaqin para komisionit në finale.

#### Specializimi: Dramaturgjia dhe skenar filmi:

Zvillimi i një skenë dramatike përmes dialogut, me shkrim sipas një rrethane të caktuar.

Përmbledhje (sinopsis) i një ngjarje të mundshme për një skenar filmi.

Testimi me gojë lidhur me njohuritë nga fusha e dramaturgjisë, kinematografisë dhe njohuri të përgjithshme.

# FAKULTETI I ARTEVE

## Specializimi: Dizajn skene dhe Kostumografi

### Faza e parë

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e vizatimit duke realizuar portret, figurë sipas modelit përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

### Faza e dytë

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e dizajnit të skenës dhe kostumeve duke realizuar një detyre kreative përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

### Faza e tretë

- Intervista dhe prezantimi i portofolios i cili duhet të jetë si vijon: (Versioni fizik në formatin A3 dhe versioni soft në email adresën arvezuale@uni-pr.edu) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e dizajnit të skenës dhe kostumeve në të cilat mund të përfshijnë (vizatime, ilustrime, dizajne të skenës, dizajne të kostumeve dhe skica ideore).

Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'i bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

- Studentët, në ditën e provimit, duhet të marrin me vete një kanavacë të formatit 50x70cm, një pako letër të formatit 50x70cm dhe lapsin e thëngjillit dhe ngjyrat sipas dëshirës.

## Specializimi: Produksion

### Faza e parë

Kandidatët që konkurrojnë në specializimin Produksion duhet t'i nënshtrohen testit me pyetje të kulturës së përgjithshme, në veçanti nga arti, filmi, televizioni, radio dhe teatri.

### Faza e dytë

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e dytë, do të nënshtrohen provimit, duke shkruar një koncept- ide të një projekti teatror, filmik, televiziv, apo artistik.

### Faza e tretë

Kandidatët do të prezantojnë, mbrojnë projektin e tyre në fazën finale, në provim gojor, para komisionit.

## Specializimi: Kamerë dhe Montazhë

Kontrolli i plotësisht të kriterëve për specializimi e studimit për kandidatët "Kamere dhe Montazh filmi" përbëhet nga dy pjesë:

1. Në pjesën e parë, të gjithë kandidatët i nënshtrohen:

-Bërja e një testi të kulturës së përgjithshme.

-Një provim me shkrim - analizë (maksimum një faqe) e një filmi të shkurtër I cili prezantohet nga komisioni vlerësues para kandidatëve rreth kadrimit dhe montazhit.

-Një provim gojor - një shtjellim i analizës me shkrim, si dhe pyetje nga fusha e Filmit, TV.

2. Pas pjesës së parë, bazuar në rezultatet, Komisioni vendos drejt përzgjedhjes së kandidatëve në një listë të shkurtër, dhe kandidatët e përzgjedhur hyjnë në pjesën e dytë të procesit të përzgjedhjes:

-Detyra praktike nga fusha e Kamerës dhe Montazhit të Filmit dhe TV, të prezantohet motivi me shkrim para komisionit, ide apo sinopsis në formë të shkruar jo më I gjatë se një faqe.

-Pastaj kandidati duhet ta realizoj filmin jo më të gjatë se 3min, pra xhirohet dhe montohet, detyra pastaj vlerësohet nga komisioni vlerësues.

-Një provim gojor ku kandidati do ta mbrojë punimin e tij para komisionit vlerësues, nga specializimi Kamerë dhe Montazh.

Bazuar në rezultatet nga pjesa e parë dhe e dytë të kontrollit, Komisioni rendit dhe zgjedh kandidatët që kanë të drejtën të regjistrohen në specializimin Kamere dhe Montazh.

## Literatura për provim pranues: Aktrim, Regji Teatri, Regji Filmi, Dramaturgjia, Dizajn skene dhe Kostumografi, Produksion, Kamerë dhe Montazhë

Ø Georg Sodull: "Historia e filmit"

Ø Abaz Hoxha: "Historia e filmit shqiptar"

Ø Luis Herman: Skenari i filmit dhe i televizionit

Ø Jezhi Plazhevski: Gjuha e filmit

Ø Fadil Hysaj: "Teatrologji, dramaturgjia, regji dhe aktrim"

Ø Aristoteli: "Poetika"

Ø Vlladan Shvacov: "Bazat e dramaturgjisë"

Ø Dr. Nebi Islami: "Historia e dramës kombëtare 1886-1996"

Ø Dr. Josif Papagjoni: "Komedi që vjen nga skena"

Ø Eskili: "Orestia"

Ø Sofokli: Një tragjedi

Ø Aristofani: Një komedi

Ø Shekspiri: Një tragjedi

Ø Molieri: Një komedi

Ø Dramaturgjia nga tradita: Anton Santori, Sami Frashëri, Kristo Floqi etj.

Ø Dramaturgjia bashkëkohore: Anton Pashku, Haqif Mulliqi, Rexhep Qosja, Ymer Shkreli, Flamur Hadri, Ekrem Kryeziu, Nebih Islami, Kasem Terbeshina etj.

Ø U. Gregor and E. Patalas: "History of Film"

Ø K. Raisz and G. Millar: "Film Editing"

Ø Marcel Martin: "The Language of Film"

Ø Jerzy Plazewski: "Jezik filma"

Ø Andre Bazin: "What is Cinema" (I, II, III, IV)

# FAKULTETI BUJQESISE DHE VETERINARISË

Testi pranues në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë organizohet me qëllim të vlerësimit të njohurive themelore të kandidatëve në lëndët përkatëse, sipas programit të studimit për të cilin aplikojnë. Lëndët e testit pranues sipas programeve të studimit.

Për programet BSC:

- **Prodhim Bimor;**
- **Prodhim Shtazor;**
- **Teknologji Ushqimore;**
- **Ekonomi e Bujqësisë,**

testi pranues organizohet nga lëndët:

- **Biologji;**
- **Kimi;**
- **Matematikë.**

Për programin:

**Mjekësi Veterinare,**

testi pranues organizohet nga lëndët:

- Biologji;
- Kimi.

## MODELE TË PYETJEVE

**Pyetjet nga lenda e Biologjise**

**Në kloroplastet e bimëve të larta janë të pranishme:**

- a.klorofilidet dhe fikocianet
- b.karotenoidet dhe fikoeitrinet
- c. klorofilidet dhe karotenoidet
- d.ksantofilet dhe fikobilinat

**Pyetjet nga lenda Kimisë:**

**Cila veti e gazit ndryshon nëse ai gaz nxehet në një enë të mbyllur:**

- a. Trysnia
- b. Shpejtësia e lëvizjes së molekulave
- c. Numri i moleve
- d. Dendësia

# FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit organizon provimet pranuese bazuar në konkursin publik të Universitetit të Prishtinës.

Administrimi I provimit pranues (Palestra ,Pishina dhe terrenet), bëhet nën mbikqyrjen e menaxhmentit të Njesisë Akademike.

Dita e parë: Provimi fillon në ora 9:00, me aftësitë lëvizore dhe lojërat sportive dhe vazhdohet në bazë të dinamikës që do të udhëhiqet gjatë ditës, përkatësisht edhe me T-Testin dhe vlerësimin teorik me shkrim në FEFS.

Dita e dytë: Provimi fillon në ora 8:00, me NOT-in në Pishinë “Gërmi” ,dhe vazhdohet me Atletikë në Parkun Taukbahqe, Prishtinë.

**Përmbajtja dhe mënyra e organizimit të provimit pranues është si në vijim:**

## **1. Njohuritë lëvizore/sportive:**

- Futboll: puna me top me këmbë dhe kokë;
- Hendboll: pasimet, trehapëshi dhe goditja në portë;
- Basketboll: pasimi me dy duar, driblimi i topit me një dorë, dyhapëshi dhe gjuajtja në kosh;
- Volejboll: pasimi i topit në çifte me gishta dhe me parakrahë, gjuajtja dhe pranimi i topit;

## **2. Aftësitë lëvizore/motorike:**

- Kërcimi nga vendi në gjatësi;
- Ngritja me forcë në hekur për meshkuj;
- Përkulje mbi krahë për femra;
- Vrapimi 100 m për meshkuj dhe femra;
- Bashkërendimi/koordinimi lëvizor;

## **3. Gjimnastikë sportive**

– lëvizje me trup të lirë: ekuilibri ballor, vertikalja mbi duar, kapërdimi para dhe rrotullimi anësor në të dyja anët, përkatësisht “ylli”, për meshkuj dhe femra;

## **4. Not: demonstrimi i njërës nga teknikat e notit;**

## **5. Agjilitet: T-testi;**

## **6. Test me shkrim: ese e shkurtër deri në 150 fjalë.**

Kriteret e poentimit përcaktohen në përputhje me aktet përkatëse të Universitetit të Prishtinës dhe rregullat e brendshme të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe të Sportit, përfshirë dispozitat që ndërliken me procesin e studimeve për studentët sportistë të kategorizuar. Kandidatët janë të obliguar që në ditën e provimit pranues të paraqiten me pajisje sportive përkatëse.

# FAKULTETI I EDUKIMIT

Fakulteti i Edukimit organizon provimin pranues sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara nga Universiteti i Prishtinës. Këshilli mësimor-shkencor i Fakulteti të Edukimit në përputhje me rregulloret në fuqi miraton procedurat dhe komisionet për organizimin, hartimin dhe administrimin e provimit pranues.

Të gjitha procedurat që duhet të ndjekin kandidatët të cilët aplikojnë në programet Bachelor apo Master janë të parapara dhe të paraqitura në konkursin publik për pranimin e studentëve i cili shpallet në ebfaqen e Universitetit të Prishtinës. Prandaj, kandidatët duhet të përciellin me kujdes të dhënat nga konkursi.

## **Provimi pranues në nivelin Bachelor:**

### **Programi Fillor, BA 240 ECTS:**

Provimi pranues do të organizohet nga fushat:

1. Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, 2. Matematikë, 3. Psikologji dhe shkathtësi analitike;

### **Edukimi në fëmijëri të hershme (0-6 vjet), BA 240 ECTS:**

Provimi pranues do të organizohet nga fushat:

1. Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, 2. Matematikë, 3. Psikologji dhe shkathtësi analitike;

### **Teknologjia Arsimore, BA 180 ECTS:**

Provimi pranues do të organizohet nga fushat:

1. Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK), 2. Matematikë, 3. Psikologji dhe shkathtësi analitike.

# MODELE TË PYETJEVE

## Gjuhë dhe letësi shqipe

**1. Ndërrimi (kalimi) i zanores a në e, si në shembujt vijues: dash-desh, natë-net, marr-merr etj., paraqet dukurinë fonetike të?:**

- a) rotacizmit
- b) asimilimit
- c) apofonisë
- d) metafonisë

**Lexoni vargjet e dhëna më poshtë dhe përgjigjuni pyetjeve në vijim:**

O malet' e Shqipërisë e ju o lisat' e gjatë!  
Fushat e gjëra me lule, q'u kam ndër mënt dit' e natë!  
Ju bregore bukuroshe e ju lumenjt' e kulluar!  
Çuka, kodra, brinja, gërxe dhe pyje të gjelbëruar!

**2.Figura qendrore e këtyre vargjeve është:**

- a) Epiteti
- b) Epifora
- c) Simploka
- d) Anafora

**3. Vargjet e mësipërme i përkasin veprës:**

- a) Çeta e profetëve
- b) Albumi
- c) Bagëti e bujqësi
- d) Këngët e Milosaos

**4. Për nga tematika këto vargje janë:**

- a) Atdhetare
- b) Religjioze
- c) Sociale
- d) Filozofike

# MODELE TË PYETJEVE

## Matematikë

**1. Lapsat shiten në pako me 10 copë, ndërsa gomat fshirëse në pako me 12 copë. Ylli dëshiron të blejë numrin më të vogël të lapsave dhe gomave në mënyrë që të ketë saktësisht një gomë për një laps. Sa pako të lapsave dhe gomave duhet të blejë Ylli?**

- a) 5 pako me lapsa dhe 6 pako me goma
- b) 6 pako me lapsa dhe 5 pako me goma
- c) 4 pako me lapsa dhe 7 pako me goma
- d) 7 pako me lapsa dhe 4 pako me goma

**2. Sa litra ujë nevojiten për ta mbushur rezervuarin e ujit në formë kubi me gjatësi të tehut 3m ?**

- a) 27 000 l
- b) 9 000 l
- c) 18 000 l
- d) 60 000 l

## Psikologji dhe aftësi analitike

**1. Sipas Maslow, kur individi përmbush nevojat fiziologjike dhe të sigurisë, ai/ajo e drejton aktivitetin e vet drejt përmbushjes së nevojave:**

- a) Biologjike.
- b) Kolektive.
- c) Psikologjike.
- d) Fiziologjike.

**2. Një nxënëse që ka studiuar frëngjisht për disa vite fillon të mësojë spanjisht. Kur përpiqet të flasë spanjisht, vazhdimisht përdor fjalë nga frëngjishtja pa dashje. Ky fenomen është shembull i:**

- a) Harresës retroaktive
- b) Harresës proaktive
- c) Interferencës së përkohshme
- d) Mësimi të përshtatur

**3. Disa nxënës ndodhen në klasa të vendosura në kate të ndryshme të një ndërtese.**

**Informacionet që dimë janë këto:**

- Lura është në një kat më poshtë se Petriti.
- Rita ndodhet në të njëjtin kat me Saren.
- Dielli është një kat më poshtë se Rroni.
- Rroni është në të njëjtin kat me Petritin.

**Duke u bazuar në këtë informacion, në cilin kat ndodhet Lura?**

- a) Në katin e sipërm
- b) Në të njëjtin kat me Rronin
- c) Në katin e poshtëm
- d) Në katin mesatar

# MODELE TË PYETJEVE

## Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)

**1. Një organizatë ka nevojë për të siguruar të dhënat e saj gjatëtransferimit në rrjetin publik. Cilin nga protokollet e mëposhtëm duhet të përdorni për të siguruar që komunikimi i të dhënave të jetë i kriptuar dhe i sigurt?**

- a) HTTP
- b) FTP
- c) HTTPS
- d) Telnet

**4.Cila nga shprehjet e më poshtme bënë bashkimin e vlerave të fushës malli dhe çmimi nëse fushat ku janë të vendosura çmimet dhe sasia e mallit janë të emërtuara Mçmimi dhe Msasia?**

- a) Vlera e mallit: [Msasia] & “;”[Mçmimi]
- b) Vlera e mallit: [Msasia] &&[Mçmimi]
- c) Vlera e mallit: [Msasia]” &” [Mçmimi]
- d) Vlera e mallit: [Msasia] & “;” & [Mçmimi]

## Udhëzime të përgjithshme për të gjithë kandidatët që aplikojnë në programet Bachelor

- Kandidatët për pjesëmarrje në provimin pranues njoftohen përmes uebfaqes së Fakultetit të Edukimi lidhur me orarin e zhvillimit të provimit dhe shpërndarjen nëpër salla.
- Kandidatët duhet të paraqiten në objektin e Fakultetit të Edukimit para fillimit të provimit dhe të kenë me vete dokument valid identifikimi dhe fletëaplikimin. Secili kandidat i nënshtrohet provimit vetëm në sallën dhe vendin e caktuar sipas listave të publikuara.
- Në hollin e Fakultetit gjithashtu gjenden administrator të cilët ndihmojnë kandidatët të cilët kanë vështirësi të gjejnë sallën dhe të orientohen brenda objektit.
- Gjatë zhvillimit të provimit, kandidatët janë të obliguar t’u përmbahen udhëzimeve të administruesve dhe të respektojnë rregullat e përcaktuara për mbarëvajtjen e procesit të provimit pranues.
- Rezultatet preliminare dhe përfundimtare të provimit pranues, si dhe afatet për paraqitjen e ankesave, publikohen në uebfaqen e Fakultetit në përputhje me afatet e përcaktuara në konkurs.

# FAKULTETI I ARKITEKTURËS

Provimi pranues për programin Bachelor në Arkitekturë ka për qëllim të vlerësojë njohuritë dhe kompetencat hyrëse të kandidatëve. Nëpërmjet tij vlerësohen mendimi logjik dhe analitik, aftësia për të perceptuar dhe interpretuar marrëdhënie hapësinore, si dhe aftësia për të vëzhguar dhe komunikuar informacionin vizual nëpërmjet paraqitjes grafike. Provimi përfshin tri fusha vlerësimi: Matematikën, Perceptimin Hapësinor dhe Vizatimin. Për shkak të natyrës dhe strukturës së tij, kohëzgjatja e përgjithshme e pjesëve të provimit është 150 minuta, ndërsa koha e pauzave ndërmjet pjesëve të provimit nuk përfshihet në këtë kohëzgjatje

## **(1) Matematika (60 minuta) – vlerëson mendimin logjik dhe analitik.**

Pjesa e provimit nga Matematika përbëhet nga detyra me alternativa, të cilat kërkojnë zgjidhje matematikore. Detyrat mbulojnë temat themelore të matematikës parauniversitare, duke përfshirë algjebren, funksionet, trigonometrinë dhe gjeometrinë. Për secilën detyrë, kandidatët janë të obliguar të paraqesin procedurën e plotë të zgjidhjes në fletët e punës të siguruar nga Fakulteti, ndërsa përgjigjja përfundimtare shënohet duke zgjedhur alternativën e saktë në shabllonin e ofruar.

Nëpërmjet këtyre detyrave vlerësohen njohuritë bazë matematikore, të kuptuarit e koncepteve themelore, mendimi logjik dhe analitik, si dhe aftësia për të analizuar, interpretuar dhe zbatuar njohuritë në zgjidhjen e problemeve.

## **(2) Perceptimi Hapësinor (45 minuta) – vlerëson aftësinë për të perceptuar dhe interpretuar forma dhe marrëdhënie hapësinore.**

Pjesa e provimit nga Perceptimi Hapësinor përbëhet nga detyra me alternativa dhe detyra që kërkojnë zgjidhje grafike, nëpërmjet të cilave vlerësohet aftësia e kandidatëve për të analizuar dhe interpretuar forma gjeometrike dhe marrëdhënie hapësinore. Detyrat përfshijnë identifikimin dhe transformimin e formave, interpretimin e projeksioneve, paraqitjen e objekteve nga këndvështrime të ndryshme, si dhe kalimin nga paraqitja dydimensionale në atë tredimensionale dhe anasjelltas.

Nëpërmjet këtyre detyrave vlerësohen orientimi hapësinor, aftësia për të vizualizuar dhe manipuluar forma në hapësirë, kuptimi i marrëdhënieve ndërmjet elementeve gjeometrike, interpretimi i projeksioneve dhe aftësia për të komunikuar forma dhe struktura nëpërmjet paraqitjeve grafike.

## **(3) Vizatimi (45 minuta) – vlerëson aftësinë për të vëzhguar dhe komunikuar vizualisht.**

Pjesa e provimit nga Vizatimi përbëhet nga një detyrë praktike me dorë të lirë. Kandidatëve u paraqitet një imazh për një kohë të kufizuar, të cilin ata e vëzhgojnë dhe më pas e paraqesin grafikisht, duke evidentuar elementet kryesore dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.

Nëpërmjet kësaj detyre vlerësohen perceptimi vizual, aftësia e vëzhgimit dhe analizës, organizimi i kompozimit, ruajtja e raporteve proporcionale, paraqitja e marrëdhënieve hapësinore dhe perspektivës, si dhe qartësia dhe cilësia e shprehjes grafike.

# MODELE TË PYETJEVE


Vlera e shprehjes

$$\frac{\cos^2 45^\circ + \sin^2 30^\circ}{2 \cos^2 60^\circ + \sin^2 45^\circ}$$

është:

- a)  $3/4$  ✓
- b)  $4/3$
- c)  $-1$
- d)  $1$

Sipas dukjeve (projeksioneve) të dhëna të objektit të skicohet me dorë të lirë forma hapësinore e tij.



Kandidati vëzhgon figurën e dhënë dhe më pas e riprodhon atë.

